



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS

Nr. 101 / Prot.

Patos, më 13 / 02 / 2026

MIRATOHET
KRYETARI
Fation Duro

PROJEKTVENDIM

Nr. 08, datë 13 / 02 / 2026

PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË QIRASË NR. 101 PROT., DATË 12.01.2026 TË LIDHUR MIDIS AGJENCISË SË ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE KONFISKUARA TIRANË DHE BASHKIVE TË QARKUT FIER ME OBJEKT QIRAJE “RRUGA HYRËSE, PESHORJA DHE VEND-DEPOZITIMI I MBETJEVE URBANE”

KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

Mbështetur në nenet 3, 8, 9, 14, 23, 32, 33, 54 shkronja “gj”, 64 pika “c” të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 10463/2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve urbane”, ligjit nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 319, datë 03.05.2018 “Për miratimin e masave për kostot e menaxhimit të integruar të mbetjeve urbane” kërkesës nr. 903 prot., datë 16.12.2025 të ndërmarrjes së pastrimit Fier për rinovimin e kontratës si qiras nr.161, datë 15.01.2025, kërkojmë nga Këshilli i Bashkisë Patos:

1. Miratimin e kontratës së qirasë nr. 101 prot., datë 12.01.2026 të lidhur midis Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara Tiranë dhe Bashkive të Qarkut Fier, me objekt qiraje **“Rruga hyrëse, peshorja dhe vend-depozitimi i mbetjeve urbane”**, pjesë përbërëse e projektvendimit.
2. Efektet financiare që do të lindin nga zbatimi i kësaj kontratës do të mbulohen nga fondi për menaxhimin e mbetjeve në Ndërmarrjen e Menaxhimit të Mbetjeve, Pastrimit dhe Gjellbërimit.

EKIPI I MENAXHIMIT TË PROGRAMIT TË PUNËVE PUBLIKE

Drejtues i Ekipit të Menaxhimit

Boreta MURATI

Anëtar të Ekipit të Menaxhimit

Eneo Xhaferi

Abiola Hoxha

Gerd Gjata

Xhevahire Gjoka

Kordinator i GMS

Ina Sauli

Juriste

Joana Sherifi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS

Nr. 101 / Prot.
2

Patos, më 13 / 02 / 2026

RELACION

PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË QIRASË NR. 101 PROT., DATË 12.01.2026 TË LIDHUR MIDIS AGJENCISË SË ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE KONFISKUARA TIRANË DHE BASHKIVE TË QARKUT FIER ME OBJEKT QIRAJE “RRUGA HYRËSE, PESHORJA DHE VEND-DEPOZITIMI I MBETJEVE URBANE”

KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

Me vendimin nr. 04, datw 03.02.2025 të Këshillit të Bashkisë u miratua kontrata e qirasë nr. 161 prot., datë 15.01.2025 të lidhur midis Agjencisë së Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara Tiranë dhe bashkive të qarkut Fier me objekt qiraje “Rruga hyrëse, peshorja dhe vend- depozitimi i mbetjeve urbane” u dha dakortësia për Bashkinë Patos, për marrjen me qira 1 (një) euro, nga Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara Tiranë dhe bashkive të qarkut Fier të rrugës hyrëse, peshores dhe vend depozitimit të mbetjeve urbane. Kjo kontratë u nënshkrua me palë qiradhënëse Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara Tiranë dhe palë qiramarrëse Bashkitë e Qarkut Fier.

Afati i kontratës është 1 (një) vit nga data e nënshkrimit me të drejtë rinovimi dhe çmimi i qirasë do të jetë 1 (një) euro në muaj, pagesa do të kryhet nga Bashkia Fier në formën e parapagimit.

Një nga detyrat kryesore e palës qiradhënëse është dorëzimi i sendit në datën e fillimit të qirasë dhe në gjendjen fizike për të cilën palët janë dakortësuar paraprakisht me njëri-tjetrin.

Një nga detyrat kryesore e palës qiramarrëse është marrja në dorëzim e objektit brenda afatit të caktuar dhe ta përdorë atë sipas destinacionit të parashikuar në kontratë.

Pasi shqyrtoi përmbajtjen dhe kushtet e parashtruara në kontratën e qirasë me propozim të Kryetarit të Bashkisë i kërkojmë Këshillit të Bashkisë:

1. Miratimin e kontratës së qirasë nr. 101 prot., datë 12.01.2026 të lidhur midis Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara Tiranë dhe Bashkive të Qarkut Fier, me objekt qiraje **“Rruga hyrëse, peshorja dhe vend-depozitimi i mbetjeve urbane”**.
2. Efektet financiare që do të lindin nga zbatimi i kësaj kontratës do të mbulohen nga fondi për menaxhimin e mbetjeve në Ndërmarrjen e Menaxhimit të

- Mbetjeve, Pastrimit dhe Gjelbërimit.
3. Për ndjekje dhe zbatimin e kësaj kontrate ngarkohet Ndërmarrjen e Menaxhimit të Mbetjeve, Pastrimit dhe Gjelbërimit, Drejtoria e Zhvillimit të Territorit dhe Emergjencave Civile

EKIPI I MENAXHIMIT TË PROGRAMIT TË PUNËVE PUBLIKE

Drejtues i Ekipit të Menaxhimit

Boreta MURATI

Anëtar të Ekipit të Menaxhimit

Eneo Xhaferi

Abiola Hoxha

Gerd Gjata

Xhevahire Gjoka

Kordinator i GMS
Ina Sauli



Jurist
Joana Sherifi

